



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

OPINION

I

AVOKATIT TË POPULLIT

R. nr. 538/2025

në lidhje me

rritjen e çmimit të energjisë elektrike nga Zyra e Rregullatorit për Energji

Drejtuar:

Z. Albin Kurti, Kryeministër në detyrë
Qeveria e Republikës së Kosovës,

Z. Hekuran Murati, Ministër në detyrë
Ministria e Financave Punës dhe Transfereve,

Znj. Artane Rizvanolli, Ministre në detyrë
Ministria e Ekonomisë,

Z. Ymer Fejzullahu, Kryesues i Bordit
Zyra e Rregullatorit për Energji

Prishtinë, më 29 maj 2025

Qëllimi

Nëpërmjet këtij Opinioni Avokati i Popullit do të ofroj qëndrimin e përgjithshëm lidhur me çështjen e rritjes së çmimit të energjisë elektrike nga Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE), si dhe efektet e krijuara nga kjo rritje, në dritën e garancive kushtetuese dhe ligjore sa i përket të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Në këtë drejtim, Avokati i Popullit do fokusohet në ndikimin e kësaj rritje në standardin e jetës së qytetarëve të Republikës së Kosovës, përkatësisht përballueshmërinë e kostos, si dhe efektin e rritjes në raport me konsumatorët në nevojë.

Avokati i Popullit do vlerësoj procedurën deri në nxjerrjen e vendimeve për rritjen e çmimit të energjisë elektrike, përkatësisht do fokusohet në transparencën duke vlerësuar pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje, dhënien e sqarimeve dhe përgjigjet e ZRRE ndaj komenteve të paraqitura, duke përfshirë informimin me kohë, si dhe përfshirjen e institucioneve vendimmarrëse të cilat janë përgjegjëse sipas Ligjit nr. 05/L-085 për Energjinë Elektrike.

Lidhur me këtë çështje, Avokati i Popullit, ka pranuar ankesë nga z. Ardian Bajraktari, avokati, përfaqësues në procedurë gjyqësore i disa subjekteve, lidhur me anulimin e Vendimit të ZRRE V_2703_2025, nr. prot. 253/25, i datës 16 prill 2025, përmes të cilit janë aprovuar tarifat me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët me të drejtë të Furnizimit me Shërbim Universal, dhe rrjedhimisht është rritur çmimi i energjisë elektrike. Përkitazi me këtë çështje, ankuesi ka kërkuar nga Avokati i Popullit që të paraqitet në cilësinë e mikut të gjykatës në procedurën gjyqësore, dhe të shprehë pikëpamjet e tij lidhur me reflektimin e çështjes kontestuese në liritë dhe të drejtat e njeriut, të garantuara me Kushtetutë dhe legjisllacionin në fuqi.

Avokati i Popullit ka pranuar ankesë edhe nga përfaqësuesit e Odës Ekonomike të Kosovës, të cilët shfaqin shqetësimin e tyre për vendosjen në tregun e hapur energjetik të konsumatorëve që kanë qarkullim vjetor mbi dhjetë (10) milion euro, ose mbi pesëdhjetë (50) punonjës.

Avokati i Popullit, duke pasur parasysh faktin se përmes këtij opinioni do jepen vetëm qëndrime parimore, konsideron se i njëjti mund të kontribuojë edhe në procedurat gjyqësore që janë duke u zhvilluar për këto çështje.

Kompetenca e Avokatit të Popullit

1. Kushtetuta e Republikës së Kosovës (më tej: Kushtetuta), në nenin 132, paragrafi 1, përcakton: *“Avokati i Popullit mbikëqyrë dhe mbron të drejtat dhe liritë e individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike.”* Kurse në paragrafin 3, përcakton: *“Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj.”*
2. Sipas Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit, ndër të tjera, ka këto kompetenca dhe përgjegjësi:

“Të tërheqë vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t’u jepet fund rasteve të tilla dhe kur është e domosdoshme të shprehë mendimin e vet mbi qëndrimet dhe reagimet e institucioneve përkatëse në lidhje me rastet e tilla.” (Neni 18, par. 1, nënpar. 1.2).

“Të njoftojë Qeverinë, Kuvendin dhe institucionet tjera kompetente të Republikës së Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me avancimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, barazisë dhe jo diskriminimit.” (Neni 18, par. 1, nënpar. 5).

“T’i publikojë njoftimet, mendimet, rekomandimet, propozimet dhe raportet e veta.” (Neni 18, par. 1, nënpar. 6).

“Avokati i Popullit mund të paraqitet në cilësinë e mikut të gjykatës (amicus curiae) në proceset gjyqësore që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut, çështjet e barazisë dhe mbrojtjes nga diskriminimit” (neni 16, paragrafi 9)

3. Me dërgimin e këtij Opinioni tek institucionet kompetente, si dhe publikimin e tij, Avokati i Popullit synon t’i përmbushë përgjegjësitë kushtetuese dhe ligjore të sipërsënuara.

Përshkrimi i çështjes

4. Avokati i Popullit ka vërejtur se ZRrE-ja, më 11 prill 2025, ka nxjerrë Vendimin V_2697_2025, me të cilin i ka aprovuar të hyrat e lejuara maksimale që do të mblidhen nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSh) - KEDS Sh.A., për vitin relevant tarifar 2025; dhe Vendimin V_2698_2025, me të cilin i ka aprovuar të hyrat e lejuara maksimale për Furnizuesin e Shërbimit Universal.
5. Lidhur me këtë çështje Avokati i Popullit ka analizuar Vendimin V_2697_2025 dhe ka vërejtur se në Pikën 2 të dispozitivit është përcaktuar se të hyrat e lejuara maksimale që do të mblidhen nga OSSh-ja për vitin relevant tarifar 2025 janë në shumën e 180.652.995 €. Në bazë të këtij vendimi, ZRRE ka nxjerrë Vendimin V_2702_2025, nr. prot. 252/25, i datës 29 prill 2025, me të cilin ka aprovuar tarifat për shfrytëzimin e sistemit të shpërndarjes (SHSSH), që do të zbatohet nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes
6. Ndërsa në Vendimin V_2698_2025, në Pikën 2 të dispozitivit është përcaktuar se të hyrat e lejuara maksimale të Furnizuesit me Shërbim Universal, për vitin 2025, do të jenë në shumën 435.926.299 €. Në bazë të këtij vendimi, ZRRE ka nxjerrë Vendimin V_2703_2025, nr. prot. 253/25, i datës 29 prill 2025, me të cilin ka aprovuar tarifat me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët me të drejtë të Furnizimit me Shërbim Universal, që do të mblidhen nga data 1 maj 2025 deri në shqyrtimin e ardhshëm tarifar.
7. Avokati i Popullit, më 21 mars 2025, ka pranuar ankesë nga z. Lulzim Rafuna, Kryetari i Odes Ekonomike të Kosovës, përkitazi me nxjerrjen e konsumatorëve nga e drejta e furnizimit si shërbim universal, të cilët kanë qarkullim vjetor më shumë se dhjetë (10) milion euro, ose më shumë se pesëdhjetë (50) punonjës. Ankuesi pretendon se komuniteti i bizneseve nuk është parapërgatitur për një gjë të tillë dhe vendosja e menjëhershme bizneseve në këtë situatë do prodhojë pasoja të rënda të cilat do kenë efekt në mjedisin biznesor por edhe tek qytetarët e tjerë të Republikës së Kosovës.
8. Avokati i Popullit më 2 maj 2025, ka pranuar ankesë nga avokati z. Ardian Bajraktari dhe të tjerët, parashtruar kundër ZRRE, përkitazi me nxjerrjen e Vendimit V_2703_2025, me të cilin ka aprovuar tarifat me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët me të drejtë të Furnizimit me Shërbim Universal. Ankuesi ka njoftuar Avokatin e Popullit se më 2 maj 2025, ka parashtruar padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë (lënda ka marrë numrin A.nr.1476/2025), dhe ka kërkuar anulimin e vendimit V_2703_2025, me të cilin janë aprovuar tarifat me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët me të drejtë të

Furnizimit me Shërbim Universal. Lidhur me këtë çështje ankuesi ka kërkuar nga Avokati i Popullit që të paraqitet në cilësinë e mikut të gjykatës (Amicus Curiae), dhe për çështjen e kontestuar të jep vlerësimin e tij nga këndvështrimi i të drejtave të njeriut.

9. Avokati i Popullit më 7 prill 2025, ka mbajtur takim me Bordin e ZRrE-së, ku janë diskutuar rrethanat dhe shkaqet sipas të cilave ZRRE e konsideron të nevojshme rritjen e çmimit të energjisë elektrike, si dhe me procedurën e zhvilluar rreth kësaj çështjeje.
10. Lidhur me këtë çështje, Avokati i Popullit më 30 prill 2025, ka dërguar Bordit të Zyrës së Rregullatorit për Energji, kërkesë për pezullimin e zbatimit të vendimit V_2697_2025 dhe Vendimit V_2698_2025, të datës 11 prill 2025. Përkitazi me këtë çështje Avokati i Popullit ka vlerësuar se nxjerrja e akteve të tilla në situata siç është aktualisht Republika e Kosovës, e të cilat i obligojnë qytetarët e Republikës së Kosovës që energjinë elektrike ta paguajnë me çmim më të lartë, prodhon pasoja të pariparueshme për të gjithë qytetarët.
11. Duke pasur parasysh këtë që u theksua më sipër, Avokati i Popullit i rekomandoi ZRrE-së pezullimin e ekzekutimit të Vendimit V_2697_2025 dhe të Vendimit V_2698_2025, të datës 11 prill 2025, deri në përfundim të hetimeve nga Avokati i Popullit lidhur me pretendimet e ankuesve rreth çështjes së rritjes së çmimit të energjisë elektrike.
12. Më 7 maj 2025, Bordi i ZRRE ka kthyer përgjigje dhe përveç njoftimeve të tjera, e ka njoftuar se *“rritja e çmimit të energjisë është një vendim i bazuar në analizat e nevojshme dhe në kërkesat e operatorëve për të mbuluar kostot e shërbimeve dhe investimeve të nevojshme për funksionimin e sistemit energjetik. Ky vendim është marrë pas një vlerësimi të detajuar dhe të konsultuar me të gjitha palët relevante, duke siguruar që të respektohen kërkesat ligjore dhe interesat e përgjithshme të qytetarëve.*

Për këto arsye Zyra e Rregullatorit për Energji konsideron se kërkesa për pezullimin e ekzekutimit të vendimeve V_2697_2025 dhe V_2698_2025 nuk është e qëndrueshme dhe se ky proces duhet të vijoj [...]”

13. Avokati i Popullit, duke pasur parasysh nenin 132, paragrafin 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, sipas të cilit përcaktohet se *“Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj.”*, konsideron se përgjigjet e autoriteteve duhet të jenë në frymën e bashkëpunimit me qëllim të mbrojtjes dhe avancimit të të drejtave të njeriut, dhe konsideron se përgjigja e tillë e ofruar nga ZRRE, nuk ka qenë në frymën e nenit 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Vlerësimi i Avokatit të Popullit

14. Avokati i Popullit duke pasur parasysh faktin se me nxjerrjen e Vendimeve V_2702_2025 dhe V_2703_2025 nga ZRRE, çmimi i energjisë elektrike në Republikën e Kosovës është rritur për rreth 16.1%, krahasuar me tarifat paraprake të energjisë elektrike.
15. Avokati i Popullit duke pasur parasysh faktin se energjia elektrike është produkt esencial për jetën, thekson se zbatimi i vendimeve të theksuara më sipër ndikon drejtpërdrejt në rritjen e kostos së jetesës së qytetarëve të Republikës së Kosovës, e rrjedhimisht do ndikojë në uljen e standardit jetësor, si dhe do të ndikojë në rritjen e numrit të familjeve që do kenë nevojë për mbështetje shtetërore, ndërsa familjeve me asistencë sociale do t’ua bëjë edhe më të vështirë mënyrën e jetesës.

16. Lidhur me takimin e mbajtur më 7 prill 2025 me disa nga anëtarët e Bordit të ZRRE, Avokati i Popullit, edhe përkundër paraqitjes së argumenteve nga ZRRE-ja për nevojën e rritjes së çmimit të energjisë elektrike, nuk është bindur se është e domosdoshme një rritje e tillë e çmimit të energjisë elektrike, në rrethanat aktuale të boshllëkut institucional që gjendet Republika e Kosovës, gjë që e ka pamundësuar zhvillimin e komunikimeve ndërinstytucionale me qëllim të gjendjes së një zgjidhjeje më të favorshme për qytetarët e Republikës së Kosovës.
17. Avokati i Popullit, duke pasur parasysh përcaktimet ligjore në Ligjin nr. 05/L-085 për Energjinë Elektrike, përkatësisht përcaktimet në nenin 49 [Mbrojtja e konsumatorëve në nevojë], sipas të cilit “*Ministria përgjegjëse për mirëqenie sociale, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për energji, Ministrinë e Financave dhe në konsultim me Rregullatorin dhe hisedarët tjerë në sektorin e energjisë elektrike, duhet të zhvillojë një program të detajuar për përcaktimin e statusit të konsumatorëve në nevojë, fushëveprimet të të drejtave të tyre, si dhe masave që kanë për qëllim mbrojtjen e konsumatorëve në nevojë në mbulimin e kërkesës së tyre për energji elektrike.*”, konsideron se në rastin konkret ka munguar një bashkëpunim i tillë ndërmjet ZRRE dhe institucioneve të tjera kompetente sipas Ligjit për Energjinë Elektrike, të cilat janë të obliguara të ndërmarrin veprime konkrete në drejtim të mbrojtjes së konsumatorëve në nevojë.
18. Avokati i Popullit, duke e ditur se zbatimi i këtyre vendimeve ka efekt të drejtpërdrejtë në të drejtat e njeriut, konsideron se ZRRE-ja është dashur të kishte komunikime më të detajuara me institucionet relevante, të cilat kanë kompetenca të caktuara sipas Ligjit nr. 05/L-085 për Energjinë Elektrike, me qëllim të gjetjes së zgjidhjeve të qëndrueshme, me qëllim të mbrojtjes së konsumatorëve.
19. Për më tepër, duke pasur parasysh efektet e drejtpërdrejta në të drejtat e njeriut si dhe duke pasur parasysh obligimin e institucioneve shtetërore sipas Ligjit për Energjinë Elektrike, Avokati i Popullit konsideron se ZRRE-ja është dashur që bashkërisht me institucionet shtetërore të gjenin një zgjidhje ku institucionet do ta mbulonin koston e ngarkesës për energjinë elektrike, në mënyrë që ndryshimi i çmimit të energjisë elektrike të mos i godas drejtpërdrejt qytetarët e Republikës së Kosovës.
20. Avokati i Popullit vlerëson se ky diskutim dhe kjo zgjidhje do të mund të bëheshin reale nëse institucionet e Republikës së Kosovës do të ishin të konstituara në kohën kur ZRRE-ja ka ndërmarrë veprimet për nxjerrjen e vendimeve të theksuara më sipër. Për këtë shkak, Avokati i Popullit thekson se procedurat e zhvilluara nga ZRRE-ja do të duhej të prisnin pas konstituimit të institucioneve të Republikës së Kosovës.
21. Avokati i Popullit është i vetëdijshëm se ZRRE-ja është organ i pavarur dhe funksionon në mënyrë të pavarur, megjithatë duke pasur parasysh përcaktimet e nenit 49 në Ligjin për Energjinë Elektrike, sipas të cilit “*institucionet e Republikës së Kosovës, në me Rregullatorin (ZRRE), duhet të ndërmarrin veprime konkrete në drejtim të mbrojtjes së konsumatorit në nevojë*”, konsideron se në këtë rast është dashur të zhvillohen komunikime konkrete me institucionet kompetente, me qëllim të gjetjes së një zgjidhjeje me të përshtatshme për mbrojtjen e konsumatorëve në Republikën e Kosovës.
22. Avokati i Popullit, duke e pasur parasysh situatën aktuale të boshllëkut institucional në Republikën e Kosovës, e konsideron hap të nxituar zhvillimin e procedurës nga ZRRE

dhe miratimin e vendimeve të theksuara më sipër, si rezultat i të cilave është ngritur çmimi i energjisë elektrike.

23. Fakti që sipas dispozitave ligjore obligohen institucionet shtetërore që të ndërmarrin veprime konkrete në konsultim me Rregullatorin, tregon se nxjerrja e vendimeve të tilla në situatën aktuale që po kalon Republika e Kosovës, nuk është realizuar në frymën e dispozitës 49 të Ligjit nr. 05/L-085 për Energjinë Elektrike, e rrjedhimisht konsumatorët e Republikës së Kosovës kanë mbetur pa mbështetje institucionale.
24. Avokati i Popullit konsideron se Qeveria e Republikës së Kosovës, në konsultim me ZRRE-në, do të duhej të ndërmerre hapa konkretë në drejtim të gjetjes së një zgjidhjeje më të përshtatshme për qytetarët e Republikës së Kosovës, lidhur me çështjen e rritjes së çmimit të energjisë elektrike.
25. Për më tepër, Avokati i Popullit, duke pasur parasysh faktin se rritja e çmimit të energjisë elektrike pritet të reflektojë në çmimin e të gjitha produkteve të tjera, vlerëson se një vendim i tillë mund të merrej pas shterimit të gjitha komunikimeve mes ZRRE-së dhe institucioneve kompetente të Republikës së Kosovës.
26. Avokati i Popullit vlerëson se nxjerrja e akteve të tilla në situata siç është aktualisht Republika e Kosovës, e të cilat i obligojnë qytetarët e Republikës së Kosovës që energjinë elektrike ta paguajnë me çmim më të lartë prodhon pasoja të pariparueshme për të gjithë qytetarët.
27. Avokati i Popullit, duke pasur parasysh dispozitat e Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, thekson se në nenin 8 [Parimi i pritshmërisë së ligjshme dhe të arsyeshme], përcaktohet se: *“1. Veprimet e organeve publike duhet të jenë të parashikueshme dhe të respektojnë pritshmëritë legjitime dhe të arsyeshme të personave. 2. Një veprim administrativ nuk mund të ndryshojë në mënyrë të pajustificuar nga një praktikë administrative e mëparshme e të njëjtit organ për raste të njëjta a të ngjashme.”*
28. Po ashtu, Avokati i Popullit vlerëson se koncepti i pritshmërisë së ligjshme dhe të arsyeshme në mbrojtjen e të drejtave subjektive është një koncept gjithëpërfshirës interpretimi në praktikën gjyqësore ndërkombëtare. Sipas GJEDNJ-së (shih rastet *Kopecky v. Slovakia*, Aktgjykimi i datës 28 shtator 2004, § 45-52; *Gratzinger dhe Gratzingerova kundër Republikës Çeke (dec.)*, nr. 39794/98, § 73, GJEDNJ 2002-VII), “pritshmëria legjitime” duhet të jetë e një natyre konkrete dhe duhet të bazohet në dispozita ligjore dhe në akte ligjore. Në rastin aktual, pritja legjitime reflektohet në garancitë e Ligjit për Energjinë Elektrike ndaj konsumatorëve në nevojë, përkatësisht obligimin e institucioneve që në konsultim me rregullatorin të ndërmarrin masa konkrete me qëllim të mbrojtjes së konsumatorëve në nevojë, e që në rastin konkret një gjë e tillë nuk ka ndodhur për shkak se procedurat e zhvilluara nga ZRRE, janë realizuar në periudhën kur Republika e Kosovës ka qenë pa institucione të konstituara, e rrjedhimisht nuk kanë ndërmarrë veprime për mbështetjen e konsumatorëve në nevojë në rastin konkret.
29. Për më tepër Avokati i Popullit konsideron se pritshmëria e ligjshme dhe e arsyeshme është e pandashme me konceptin e sigurisë juridike, dhe se të dyja konceptet nuk mund të interpretohen ndaras njëra nga tjetra. Në këtë drejtim Avokati i Popullit thekson se koncepti i sigurisë juridike në këtë rast nënkupton faktin që institucioni duhet ti ndërmerr

veprimet konkrete të bazuara në dispozita ligjore të cilat në mënyrë të qartë kanë rregulluar çështjen në fjalë.

30. Prandaj duke pasur parasysh rrethanat e theksuara më sipër, e po ashtu duke pasur parasysh konceptin e pritshmërisë së ligjshme dhe të arsyeshme dhe të sigurisë juridike, Avokati i Popullit vlerëson se është e domosdoshme që për veprimet e tilla institucionet të zbatojnë dispozitat e ligjeve konkrete dhe vetëm pasi që të jenë plotësuar kushtet e përcaktuara me legjislacionin që rregullon fushën konkrete, dhe shterimin e konsultimeve me institucionet relevante, të ndërmarrin hapa në drejtim të vendosjes lidhur me çmimin e energjisë elektrike.
31. Avokati i Popullit ka analizuar procedurën e nxjerrjes së vendimeve të theksuara më sipër dhe ka vërejtur se procedura e zhvilluar nga ZRRE nuk është zhvilluar me transparence efektive, e në disa raste është zhvilluar fare pa transparence. Avokati i Popullit thekson se një procedurë nuk mund të qohet me transparencë nëse nuk merren parasysh komentet e grupeve të interesit të cilët kanë paraqitur shqetësimet e tyre lidhur me ngritjen e çmimit të energjisë elektrike.
32. Për më tepër, fakti se ZRRE nuk e ka bërë të ditur deri në fund të procedurës përqindjen (%) e rritjes së çmimit të energjisë elektrike dhe vetëm pas miratimit të vendimeve të theksuara më sipër qytetarët e Republikës së Kosovës e kanë mësuar se sa është rritur çmimi i energjisë elektrike është tregues se kjo procedurë nuk është zhvilluar me transparencë sipas kërkesës së Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht nuk është vepruar në pajtim me nenin 70 [Përmbushja e shërbimeve publike të interesit të përgjithshëm], paragrafi 1, sipas të cilit përcaktohet se: *“Në rastet kur një shërbim publik i interesit të përgjithshëm përmbushet nga një ofrues publik apo privat i shërbimeve sipas të drejtës private, organi publik i ngarkuar nga ligji me kompetenca rregullatore, mbikëqyrëse apo licencuese (në vijim ”organi rregullator”), përmes zbatimit të përgjegjësi të veta mbikëqyrëse do të sigurojë vazhdimësinë, njëtrajtshmërinë, përballueshmërinë dhe cilësinë e përshtatshme të shërbimit, transparencën e procedurave dhe mosdiskriminimin e përfituesve të tij.”*.
33. Lidhur me çështjen e ngritur nga Oda Ekonomike e Kosovës, Avokati i Popullit thekson se nxjerrja e konsumatorëve të cilët kanë qarkullim vjetor më shumë se dhjetë (10) milion euro, ose më shumë se pesëdhjetë (50) punonjës, nga e drejta e furnizimit si shërbim universal do të rëndoj akoma më shumë çështjen sociale në Republikën e Kosovës.
34. Në këtë drejtim, Avokati i Popullit vlerëson gjatë nxjerrjes nga e drejta e furnizimit si shërbim universal, të konsumatorëve të tillë të cilët kanë qarkullim vjetor më shumë se dhjetë (10) milion euro, ose më shumë se pesëdhjetë (50) punonjës, nuk u është dhënë kohë e mjaftueshme për përgatitje, kur kemi parasysh faktin se operatorët e tjerë nuk kanë krijuar kushte për oferta në përputhje me standardet e kërkuara, e që rrjedhimisht shpie në monopolizimin e tregut, dhe si rezultat i kësaj do shkaktojë një zinxhir të çrregullimit të tregut për produktet e nevojshme për jetën e qytetarëve të Republikës së Kosovës.
35. Avokati i Popullit duke pasur parasysh faktin se për këto kategori do të ketë rritje edhe më të madhe të çmimit të energjisë elektrike, konsideron se ekziston rreziku real që çmimet e produkteve me të cilat kanë aktivitete këto subjekte do të ngritën dhe do e vështirësojnë akoma më shumë standardin jetësor të të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës.

36. Prandaj, duke e pasur parasysh këtë çështje, Avokati i Popullit shpreh shqetësimin se ky veprim në këtë situatë do i godas dyfish ekonominë familjare dhe biznesore të qytetarëve të Republikës së Kosovës, prandaj vlerëson se në situata realisht serioze institucionet relevante kanë detyrë që të angazhohen bashkërisht që të gjejnë zgjidhje e cila do i mbështesë konsumatorët në Republikën e Kosovës, dhe do të krijojë mjedis të përshtatshëm për zhvillim të biznesit.

Përfundim

37. Në bazë të rrethanave të theksuara më sipër Avokati i Popullit vlerëson se është obligim i të gjitha institucioneve të Republikës së Kosovës që në bashkëpunim ndërmjet tyre t'i realizojnë detyrimet ligjore në drejtim të mbrojtjes së konsumatorëve në Republikën e Kosovës.

38. Avokati i Popullit thekson se vakumi institucional e ka pamundësuar reagimin e Qeverisë dhe institucioneve të tjera përgjegjëse sipas Ligjit për Energjinë Elektrike në drejtim të gjetjes së zgjidhjes për konsumatorët në nevojë, por edhe të konsumatorëve të tjerë të cilët afektohen nga kjo rritje.

39. Avokati i Popullit thekson se në rastin konkret ZRRE, nuk i ka zhvilluar procedurat e nxjerrjes së vendimeve të tilla me transparencë sipas kërkesës së nenit 70, të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

40. Në këtë drejtim, Avokati i Popullit vlerëson se institucionet kompetente duhet të zhvillojnë procedurat në pajtim me kërkesat ligjore për transparencë dhe mbrojtje të konsumatorëve në nevojë, në mënyrë që qytetarët e Republikës së Kosovës ta kenë të qartë procedurën e cila zhvillohet, si dhe objektin e çështjes për të cilën vendoset.

41. Avokati i Popullit thekson se Qeveria e Republikës së Kosovës ka obligim të veprojnë në përputhje me dispozitat e Ligjit për Energjinë Elektrike, në mënyrë që vendimet e tilla të ZRRE, të përcillen me masa përmes të cilave do mbrohen të drejtat e konsumatorëve në nevojë dhe kategoritë e tjera të cenueshme, e po ashtu të ndërmarrin masa konkrete me qëllim të krijimit e kushteve të përbalueshme edhe për komunitetin e biznesit.


42. Po ashtu Avokati i Popullit thekson se gjatë nxjerrjes së vendimeve të theksuara më sipër nuk është plotësuar standardi i kërkuar me nenin 49 të Ligjit nr. 05/L-085 për Energjinë Elektrike, duke rezultuar kështu në pamundësinë e ofrimit të mbështetjes për konsumatorët në nevojë.

43. Lidhur me këtë çështje Avokati i Popullit konsideron se në rastin konkret ZRRE është dashur që procedurat e tilla t'i zhvilloi pas konstituimit të institucioneve të Republikës së Kosovës, dhe pastaj në konsultim me ato të gjejnë zgjidhje më të favorshme për qytetarët.

44. Po ashtu, Avokati i Popullit thekson se Qeveria e Republikës së Kosovës është dashur që në konsultim me ZRRE të gjej një zgjidhje të përshtatshme tek rasti i nxjerrjes së konsumatorëve nga e drejta e furnizimit si shërbim universal të cilët kanë qarkullim vjetor më shumë se dhjetë (10) milion euro ose më shumë se pesëdhjetë (50) punonjës, sepse kjo situatë ka rrezik të shkaktojë një inflacion të ri i cili mund të rezultojë me situatë të papërbalueshme për ekonominë familjare të qytetarëve të Republikës së Kosovës, e po ashtu mund të rrezikojë ekzistencën e ndonjë subjekti afarist si dhe krijon mjedis jo të favorshëm për zhvillimin e aktiviteteve biznesore në Republikën e Kosovës.

45. Avokati i Popullit e ri përsërit qëndrimin se është e nevojshme që nga ZRRE të pezullohet zbatimi i vendimit V_2697_2025, Vendimit V_2702_2025, nr.prot. 252/2025, i datës 29 prill 2025, vendimit V_2698_2025, dhe vendimit V_2703_2025, nr.prot. 253/2025, i datës 29 prill 2025.
46. Në fund Avokati i Popullit thekson se është obligim i secilit institucion në Republikën e Kosovës, pa dallim statusi apo regjioni, që të angazhohen në drejtim të ofrimit të shërbimeve në të mirë dhe dobi të qytetarëve të Republikës së Kosovës, duke respektuar Kushtetutën dhe dispozitat ligjore në fuqi.

Me nderime,

Naim Qelaj

Avokat i Popullit